

Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosova



012

e-mail: newspwd@yahoo.com

Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara



Iniciatore për fillimin e botimit të kësaj gazete është Zyra Amerikane në Prishtinë.
"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo mendoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

Mirë se erdhët në botën tonë

Kjo gazetë joprofitabile botohet në pesë gjuhë: si shtojcë në gjuhën shqipe distribuohet përmes të përditshmes (Koha Ditore), në gjuhën boshnjake përmes (Alem), në serbishte (Jedinstvo) dhe gjuhës turke (Jeni Donem). Në këto gjuhë dhe versionin anglisht mund ta lexoni edhe përmes website www.lpkosova.com
Bashkpunëtorë vullnetarë e redaksisë Diana Toska

Letër personave me aftësi të kufizuar

ME VETINICIATIVË PO AVANCONI MIRËQENJEN TUAJ

Zonja dhe zotrinj,
Miq të dashur

Ju drejtohem me pak fjalë për t'u treguar se do të jem me ju dhe se angazhimi im për përmirësimin e cilësisë së jetës suaj nuk do të pushoj asnjëherë.

Me plot të drejtë e them se ka lëvizje pozitive në krijimin e kushteve më të mira për veprimtarinë tuaj, por po ashtu jam i vetëdijshëm se kjo që është bërë nuk mjafton dhe se përpjekjet e institucioneve në këtë drejtim vetëm sa do të intensifikohen. Këtë e meritoni, ngase po u prini me

vetiniciativë realizimit të përpjekjeve të cilat avancojnë mirëqenjen tuaj në shoqërinë kosovare.

Përcaktimi i statusit përfundimtar për Kosovën, e ai do të jetë pavarësia e saj, do të krijojë kushte më të mira për funksionimin e institucioneve të vendit dhe krijimin e rrethanave shumë më të favorshme për kategorinë e qytetarëve me aftësi të kufizuara veprimi. Vendi ynë do të jetë zbatues i të gjitha konventave ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e personave me aftësi të kufizuara.

Pres që zëri juaj, i mekanizmave të cilët i keni të ndërtuar e do t'i ndërtoni në të ardhmen do të jetë komplementar me angazhimet e përgjithshme të shoqërisë sonë dhe të institucioneve demokratike të saj. Vetëm kësajsoji do të vëmë baza të shëndosha organizimit tonë institucional në shërbim të të gjithëve në vendin tonë.

Me besim të plotë se viti i ardhshëm do të jetë vit i realizimit të aspiratave të popullit të Kosovës, ju uroj juve dhe familjeve tuaja të cmuara jetë të dinjitetshme dhe përfshirje më të madhe të kësaj pjese të qytetarëve tanë në proceset të cilat do të na përcjellin në të ardhmen.

Ju uroj festat e fundvitit dhe një vit të begatshëm 2007.

I Juaji,

Dr. Fatmir Sejdiu

President i Kosovës

Prishtinë, 2006



GJUHA E SHENJAVE

NJË EKSPozIM I SUKSESSHËM

NJË DITË E SHËNUAR

KOMITETI I GRAVE TË VERBËRA

Qeveria mbështet partneritetin e OJQ-ve në Programin Multietnik Vullnetar Promovues të DMD-së

Personat me aftësi të kufizuar perbejnë shtresën me standarte të ulta ekonomike, me mundësi më të pakta punësimi, me aftësi të kufizuar lëvizjeje, e më nje fjalë, gëzojnë të drejta njerëzore në përgjithësi të kufizuara. Mirëpo kohëve të fundit, e sidomos pas luftës, u bënë shumë lëvizje të cilat gradualisht vijnë drejt mundësive më të mira për një jetë më të mirë ndaj presonave me aftësi të kufizuar.

Në çdo dokument shkruhet se çdo qytetar duhet të ketë të drejtën dhe shansin, pa dallime gjinie moshe, race, feje, aftësive të kufizuara mendore, fizike etj, dhe në bazë të kësaj Qeveritë kanë për obligim të veprojnë drejt masave efikase për të siguruar që Personat me Aftësi të Kufizuar të gëzojnë të drejtat e barabarta.

Për të bërë që Qeveria të ketë sukses në realizimin e gjithë veprimeve rol të madh luan edhe vullnetarizmi si nje pjesë e rëndësishme në mirëqenien dhe përparimin e Personave me aftësi të kufizuar, e sidomos në zhvillim e një sistemi të ri të pas luftës në Kosovë. Vullnetarizmi merr forma dhe kuptime të ndryshme në ambiente të ndryshme. Ai ndikohet shumë nga historia, politika, feja dhe kultura e një rajoni.

Si shembull konkret kemi rastin e partneritetit të OJQ-ve në Programin Multietnik Vullnetar Promovues të DMD-së, e cila është një praktikë shumë e mirë për përgatitjen e kushteve tona në implementimin e qëllimeve nga Konventa e Re mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.


Një partneritet i fortë bëri që edhe Kosova të jetë pjesë aktive e

tërë këtijë procesi, duke iu falënderuar donatorëve të ndryshëm Ndërkombëtarë dhe Kombëtarë që veprojnë në Kosovë.

Zyra jone, duke u bazuar edhe në mandatin e saj, do të vazhdojë t'i rekomandojë përmirësime dhe ndryshime pozitive në çdo aspekt duke marrë parasysh gjithënjë respektimin e Konventave për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, e në këtë rast edhe të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Prandaj, Zyra e Kryeministrit/ Zyra për Qeverisje të Mirë, mbështetin partneritetin multietnik të OJQ-ve në Programin Vullnetar Promovues të DMD-së, duke shpresuar se e gjithë kjo punë do të vazhdoj edhe më tutje me një përkushtim më të madh për mbrojtjen e të drejtave të Personave me aftësi të Kufizuar në Kosovë.

Habit Hajredini
Drejtor i Zyrës për
Qeverisje të Mirë



KOMITETI I GRAVE TË VERBËRA

INTERVISTË

Me zonjën, Bajramshahe Jetullahu kryetare e OJQ, "Komiteti i grave të verbëra", punëtore humanitare, nënë e përkushtuar e katër fëmijëve të rritur dhe gjyshe e tetë nipave.

z. Bajramshahu kur themeluat shoqatën të cilën sot e udhëhiqni?

Komiteti ynë është multietnik dhe tubon të gjitha gratë e verbëra pamarparasysh përcaktimin, racor, fetar a kombëtar. Më parë kemi punuar nëpër, seksione, e më pas themeluan OJQ "Komitetin e grave të verbëra" të inicuar nga Unioni botëror i të verbërve, më saktësisht me përkrahjen e kryetares së këtij unioni, z. Kiki Nordstrom, e cila ka vizituar Kosovën. Dua ti falenderoj donatorët tanë, Zyrën amerikane në Prishtinë, Zyrën Holandeze dhe FDI-në.

Cilat janë qëllimet e planet tuaja?

Qëllimet kryesore të organizatës sonë janë, emancipimi, edukimi dhe mësuerja e shkrim leximit për gratë e verbëra. Ndërkohë që ndër planet kryesore të punës kemi vendosur, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të verbër të cilat janë inkorporuar në Konventën e re e të cilën do të angazhohemi ta implementojmë në Kosovë.

Cila është perspektiva e

kësaj Konvente sipas jush?

Konventa është shumë përmbajtsore dhe paraqet një hap para, drejt përmisimit të statusit tonë, por së pari ajo duhet implementuar nga të gjithë faktorët e shoqëris sonë.

Ju jeni nënë e verbër e katër fëmijëve, sa ka qenë vështirë ti ritni e edukoni dhe a ka patur kush tju ndihmojë?


Nuk është e lehtë të jesh nënë e verbër. Mua askush nuk më ka ndihmuar në ngritjen e tyre, sepse edhe burri im është i verbër. Kisha nevojë për shërbime të servisit, mirëpo tek ne as sot e kësaj dite nuk ekzistojnë shërbime të tilla. Jam munduar që fëmijët e mi ti edukoj dhe mësoj që heret ata të kuptojnë se unë jam e verbër dhe se kam nevojë për ndihmën e tyre. Kisha shumë problem me fëmijun e parë, më pas u mësova me përgjegjësit e prindit. Më kujtohet kur i kam thënë fëmijës së parë se nuk po ja shoh se ku e ka çorapën, ajo më kuptoi dhe mori dorën time e vendosi mbi çorapë. Ky është vetëm një nga shembujt e përditshmëris. Unë sot, jam nënë dhe gjyshe e lumtur. Gratë e verbëra nuk guxojnë të frigsohen nga bukuria e të qenurit nënë, fëmija të jep kurajo, ta edukosh si është më mirë për te dhe do ta kthejë lumturin e jetës.

Çfarë duhet bërë shoqëria për gratë e verbëra?

Duhet organizuar shërbime të servisit, si ndihmë në punët e shtëpis, përcjellje, punësim që të mundet ajo vetë ta mbajë familjen, së fundi të gjitha këto në shtetet demokratike janë shumë mirë të organizuara. Ne duhet ta ndjekim shembullin e tyre.

Çka kishit porositur lexuesit tanë?

Çdo grua pamarë parasysh aftësinë e saj të kufizuar duhet të arsimohet, nuk guxon të mbyllet në shtëpi e të izolohet nga shoqëria. Po e shfrytëzoj këtë rastë ti thërras të antarësohen në shoqatën tonë multietnike.



Unifikimi i përvojave të ndryshme na bën më të fuqishëm në veprim.

Një ndër fitoret botërore vitin që lamë pasë, padyshim se është miratimi i Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, marëveshja e parë dhe më e vlerësuar e shekullit 21 mbi mbrojtjen e të drejtave të 650 milion njerëzve të planetit tonë.

Kosova në mënyrë aktive morri pjesë në përpunimin e tekstit të kësaj Konvente në K.B. me çka dëshmoi përkushtimin e saj në sferën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Pas zgjidhjes së statusit të Kosovës dhe pranimit e saj anëtare të barabartë në KB, qeveria jonë duhet ta ratifikojë këtë Konventë, ndërsa kusht i domosdoshm për implementimin e saj, sipas meje është uniteti i OJQ-ve që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara.

Vetëm Uniteti i plotë i OJQ-ve do të mund ta mbroj dhe siguroj gëzimin dhe barazin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në misionin e tyre të shpirtë për një jetë më të dinjitetshme. OJQ-të e Kosovës kanë lider me kapacitete të lakmueshme, intelektuale, kombëtare e profesionale dhe të cilët për hir të detyrave historike që qëndrojnë para tyre janë të gatshëm të vendosin një

bashkpunim më kualitativ dhe krijojnë - Lëvizjen e Unitetit të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Nuk është aspak e lehtë të kuptohen pikpamjet dhe përvojat e ndryshme që kemi. Të verbërit nga bota e tyre e erët kërkojnë dritë nga shoqëria, shurdhmemecët luftojnë për zë të artikuluar mes shenjave, personat shtatshkurtër apelojnë për pak rritje të vëmendjes në rrethin ku jetojnë ... nevojat janë të ndryshme dhe nga më të llojllojshmet, mirëpo këmbimi i përvojave na bën më të fuqishëm dhe na jep forcë e kurajo për tejkalimin edhe të barrierave më të rënda. Ekziston një propozim në nivel global të mos diskutojmë për diagnoza sepse ato nuk kanë lidhje me përcaktimet tona politike për botën ku duhet të kyqemi si partner të barabartë.

Ne mund të jemi të lumtur poqese fillojmë ti ndërtojmë urat në mes botrave tona, për këte nevojitet vetëm vullneti i mirë për UNITET.

Duke Ju dëshiruar shëndet mbes me shpres që viti 2007 për personat me aftësi të kufizuara të jetë një vit i mbarësis ku diskutimi i hapur e ballë për ballë do të çojë drejt realizimit të aspiratave tona për një jetë më të devotshme.

Me respekt,
Hiljmnijeta Apuk



GJUHA E SHENJAVE TË KOSOVËS

Tri vitet e fundit është në përgaditje e sipër libri, "Gjuha e shenjave të Kosovës" për shurdhmemecët e cila ngërthen në vete materialet e grumbulluara nga mbarë Kosova.. Në përputhje me Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara Neni 2. parasheh detyrimin e çdo shteti që në »gjuhën e tij« të përfshijë edhe shenjat e të folurit të gjuhës dhe format tjera të gjuhës së pafolur. Tani po bëhet përpjekje që institucionet të pranojnë "gjuhën e shenjave të Kosovës" si njëra ndër gjuhët që komunikohet në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti të donuar nga Ministria e punëve të jashtme të Finlandës dhe Shoqata e shurdhmemecëve nga ky shtet po mbahen, tri lloje të trajnimeve në temat në të cilat janë shkruar broshurat: trajnim organizues për shurdhmemecët, trajnim për përkthyesit dhe zhvillim të gjuhës së shenjave. Trajnimet po mbahen dy herë në muaj në Prishtinë dhe përfshijnë pjesmarësit nga mbarë Kosova.



NJË SHEMBULL QË DO PËRKRAHJE



Shkolla për shurdhmemec "Nëna Tereze" në Prizren ofron bashkpunim prodhues me afaristët me qëllim të themelimit të një fondi nga i cili do të mund të organizoheshin, aktivitete të ndryshme kulturore, ekskursione dhe stipendione.

Caritasi gjerman ka donuar, makina të ndryshme për përpunimin e drurit, metalit dhe për qepje, ndërsa shkolla "Nëna Tereze", ka adaptuar lokalet e saja për vendosjen e këtyre makinave. Shkolla ka 3 ligjërues inzhenjer të cilët mbajnë kurse tremujore profesionale dhe përgadisnin nxënësit në këto zanate.

Programi prodhues ofron përpunimin e këtyre sendeve:

Nga druri: kuzhina të llojllojshme nga druri dhe paneli, regale, tavolina, karike e gjësende të tjera me porosi.

Nga metali: përpunimin e ollukëve për shi, mbajtës të ollukëve, prodhimin e të gjitha konstrukcioneve metalike, pjesëve rezervë për makina të ndryshme dhe çdo porosi.

Robaqepsi: fustane të modeleve të ndryshme si për ditë ashtu edhe solemne, pixhame, ndërresa e shumë gjëra të tjera sipas nevojës.

Prodhuesit e interesuar për bashkpunim mund të paraqiten në Shkollën "Nëna Tereze" në Prizren apo të kontaktojnë me Drejtoreshën Sutjeska Fanaj.

H.A.

MBARËSI NË VITIN E RI 2007 NGA DONATORËT E REVISTËS!



MINISTRIA E EKONOMISË
DHE FINANCEVE



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.Ç.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ,
të gjithë qytetarëve të Kosovës Ju uron
festat e fundvitit dhe Vitit të Ri 2007,
në veçanti personave me aftësi të
kufizuar.



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS GOVERNMENT OF KOSOVO VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA



Kuvendi i Kosovës
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME
TË VETËQEVERISJES



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT
URED PRIMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

ZYRA KËSHILLËDHËNËSE PËR QEVERISJE TË MIRË
SAVETODAVNA KANCELARIJA ZA DOBRO UPRAVLJANJE
ADVISORY OFFICE FOR GOOD GOVERNANCE

*Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit i uron të gjithë
Personave me Aftësi të Kufizuara, familjarëve dhe organizatave të tyre, Vitin e
Ri, me dëshirën që ky vit të jetë më i frytshëm në përmbushjen e objektivave të
programit të Qeverisë për çështjen tuaj madhore.*

Gëzuar 2007

Habit Hajredini
Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS GOVERNMENT OF KOSOVO VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU

OSCE
Mission in Kosovo



Simbolet e reja amerikane si “ME DYER TE HAPURA” apo me “DYER PA DRY” kanë për qëllim nxitjen e ideve të reja dhe filozofisë jetësore të personave me aftësi të kufizuara. Porosia e tyre është e qartë: të dilet nga shtëpia, personi të socializohet me rrethin ku jeton, ta përjetojë lirinë e lëvizjes dhe mundësit që i ofron shoqëria, si qasja në transportin publik, objektet me destinim të ndryshëm ...

Simbolet kanë porosin e qartë nëse hapim derën e dhomës sonë, kemi hapur derën e tërë botës, sepse një derë e mbyllur është bariera dhe sfida e parë për personin me aftësi të kufizuara, për familjen e tij dhe shoqërinë në përgjithësi.



SKUTER SA NJË KOFER



Personave me lëvizje të vështërsuar, dizajnimi i skuterit të ri amerikan “Lexus Light” i cili peshon vetëm 24 kg dhe kur palohet arin madhësin e një valixheje, është një zbulim i cili ua lehtëson bukur shumë lëvizjen personave me aftësi të kufizuara. Ky skuter mund të vendoset në kabinën e aeroplanit dhe bagazhin e veturës pa asnjë problem. Mund të vozitet edhe nëpër shi, ngase bateria nuk preket me sipërfaqen e rrugës. Në vitin 2005 ky zbulim fitoi 5 yje për dizajn më të mirë. Në foto mund të shihet skuteri i hapur dhe i paluar. Mund të blihet direkt përmes website dhe tua sjellin në adresën ku jetoni në Kosovë. Çmimi është US \$1.675.


Më shumë informata mund të gjeni në Websitin në adresën:

<http://www.planetmobility.com/store/scooters/planet/lexuslight/used.html>

KOMBET E BASHKUARA - NEW YORK



Më 13 dhjetor, 2006: e tërë bota festoi çastin kur Ansambleja Gjenerale e KB, miratoi tekstin punues të Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ndërkohë që këtë mesazh botës i a përcollti në emër të rrjetit global të RI, z. Maria Veronica Reina nga Burton Blatt Institute at Syracuse University, USA.



TRAJNIM PER AVOKIM TE SUKSESSHEM

OJQ Hendikep Kosova dhe REA (Agjencioni regjional për ndërmjetësim) ka organizuar një trajnim pesditor nga 04-08 dhjetori me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara. Ky program përmbante 6 pika të rëndësishme:

- përpilimi i propozim projektit,
- Ndërtimi i relacioneve me donatorët
- Oavokimi
- Raportimi
- menagjment asociimi
- projekt implementimi.

“qëllim i këtij projekti ishte ndihma dhe përkrahja personave me aftësi të kufizuara si dhe asociacionet që meren me këtë çështje në aftësimin profesional të tyre për përpilimin e projekteve dhe implementimin e tyre, përfitim i shkathtësive për avokim të mirë dhe përfitim të donatorëve dhe qeveris.” njoftoi z. Meti Jetullahu, Drejtor i REA.

“DALLONI PRIORITETET - KOMUNA E PRIZRENIT”.

HANDIKOS-i është organizatë joqeveritare lokale e cila punon me dhe për persona me aftësi të kufizuara. Është themeluar dhe regjistruar në UNMIK si zyre e OJQ-ve në vitin 1982, dhe ka rrjet të gjërë të shtrirjes, (25 zyre dhe 10 qendra të bazuara në bashkësi), në teritorin e Kosovës.

Në qendrën e Handikosit në Prizren janë të regjistruar, 126 fëmijë nga mosha 1-14 vjeçe. Në aktivitetet psiko-sociale dhe fizio terapis janë të përfshirë, 38 fëmijë. Për shkak të mungesës së karburantit kjo qendër nuk mund të përfshijë numër më të madh të fëmijëve.

Nga institucionet komunale na kanë ngelur vetëm premtimet. Këtë vit para se të miratohet buxheti i vitit 2007 e kemi përsëritur projektin e një viti më parë dhe shpresojmë në përkrahje. Meqëse kemi ankesa të shumta nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk mundemi ti përfshim në terapi do të jemi të detyruar të organizojmë protesta para institucioneve tona relevante me një mesazh të qartë, duam kushte e jo mëshirë, njofton ndër të tjera për gazetën tonë, ass. menaxherja Drita Vukshinaj.



NJË DITË E SHËNUAR

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara më 3. dhjetor u mbajt koncert tanimë tradicional me program të pasur, kulturo artistik, nën oragnizimin e OJQ “Hendikep Kosova”. Në program morrën pjesë, përveç personave me aftësi të kufizuara edhe anëtarët e ansambllit “ Shota”, Ilir Shaqiri, nxënësit e shkollës speciale për të verbër nga Peja dhe ata nga “ Përparimi” nga Prishtina. Këtë manifestim e shpalli të hapur, përfaqësi i Zyrës së Kryeministrit, z. Afrim Krasniqi. z. Gëzim Abazi, Kryetar i OJQ “Hendikep Kosova”, ka deklaruar me atë rastë: - Duhet kujdes dhe trajtim më i kujdesshëm i shoqëris ndaj kësaj kategorie qytetarësh, ngase ata janë pjesa vitale e këtij trualli. Gjatë vitit 2007 presim miratimin e Ligjit i cili do të përmisojë statusin tonë. Donatorë të këtij manifestimi ishin: Ministria e Kulturës dhe Departamenti për sport, kulturë e rini.

SHIJUAN ATMOSFEREN FESTIVE

Janar 1, 2007: OJQ Hendikos me rastin e ndërrimit të vitit organizoi një kremte në Hotel, “ Jeta “ në Gjakovë, me çrast personat me aftësi të kufizuara patën rastin të shoqërohen, argëtohen e shkëmbejnë urimet mes tyre. Nën tingujt e një muzike të zgjedhur dhe sofere të begatë numër shumë i madh i pjesmarrësve u argëtua, duke vetfinansuar me nga 12 euro për person këtë party në të cilën u gëzuan dhe shijuan atmosferën festive shumë persona me aftësi të kufizuara si kur më parë.



KOMITET PËR MË SHUMË DINJITET

Me iniciativë të delegatëve të Komunës së Prizrenit u themelua, Komiteti parlamentar për çështjet e personave me aftësi të kufizuara i përbërë nga 9 anëtarë nga të cilët 5 antarë nga rradhët e delegatëve komunal dhe 4 antarë nga OJQ-të.

Antarë të Komitetit janë:

- Qemal Kurtishi, Kryetar i Komitetit dhe nënkryetar i KK
- Drita Vukshinaj Nënkryetare e OJQ Hendikos
- Dushe Rezaj delegate e LDK
- Mybegjele Zhuri delegate e PDK nga shkolla për shurdhmemec
- Zeni Hasani Deleгат nga PET
- Dr. Jasemin Kovaç nga KDTP parti turke,
- Bersimka Elezi Kryetare e shoqatës së të verbërve nga Prizreni
- Nedret Randobrava antarë i OJQ shoqata e shurdhmemecëve nga Prizreni
- Bashikm Gashi KMDLNJ

Me donim nga OSBE-ja është botuar një broshurë në temën, “Komiteti për personat me aftësi të kufizuara” me qëllim të analizimit të gjendjes në teren, hulumtimin e rasteve të diskriminimit në fushat e arsimit, kulturës e politikës, përmbledhja e të dhënave themelore mbi institucionet publike ku është e domosdoshme nevoja e modifikimit të infrastrukturës me qëllim të lëvizjes së papenguar e të lehtë për personat me nevojë.



Z. Qemal Kurtishi,
Kryetar i Komitetit dhe nënkryetar i KK

Qëllimet e Kuvendit të Komitetit janë:

- avokimi dhe lobimi përmes fushatave të cilat do ta vetëdisonin opinionin për nevojat e personave me



- aftësi të kufizuara,
- ndërtimi i kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara në bazë të kurseve për aftësim profesional,
- krijimi i kontakteve në mes të nivelit lokal e qendror me qëllim të krijimit të vendimeve obligative për krijimin e kushteve për qasje pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara,
- prezentim të raporteve punuese të Komitetit para KK së bashku me rekomandimet për përmisim të statusit,
- raportimin e rasteve rreth mos respektimit të kërkesave të Komitetit dërguar, Komitetit për bashkësi me qëllim të zgjidhjes së tyre në formë institucionale.

“Po bëjmë përpjekje të apelojmë për lehtësira tatimore për punëdhënësit të cilët punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Po përpiqemi që me ligj ti rregullojmë dhe sigurojmë, parkingjet dhe deri më tash kemi arritur që 5 parkingje ti evidentojmë. Kemi biseduar me Drejtorin e spitalit dhe shtëpive shëndetsore të mundësohet qasje në këto objekte me rastin e kontrollimeve mjeksore. Apelojmë njësoj në transportin publik, tek shkollat e shumë apele tjera kemi bërë por jo duke kërkuar mëshirë nga shoqëria, por si të drejtë që ju takon personave me aftësi të kufizuara të ndjehen të barabartë me të tjerët.” na tha ndër të tjera Qemail Kurtishi.

Foto shënim

NJË EKSPOZIM I SUKSESSHËM

Në panairin tradicional që e organizon Ministria për tregti e turizëm morri pjesë edhe OJQ Hendifer nga Ferizai, në stendën e së cilës u ekspozua me shumë sukses programi prodhues i mjeteve ndihmëse ortopedike.



ZËRI YNË - në RTV 21


Në bashkpunim në mes të OJQ “Hendikep Kosova” dhe RTVI 21 filloi realizimi dy herë në muaj i emisionit televiziv me titull, “Zëri Ynë” e cila trajton çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara. Redaktor përgjegjës i këtij emisioni është juristi, Gëzim Abazi. Donatorë të këtij projekti medial janë: SOROSI, Drejtorati i mbrojtjes sociale i Komunës së Prishtinës dhe “SIGURIA”.



Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosovo

Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

**RESPEKTONI:
INTEGRITET
PA DISKRIMINIM
DALLIMET**



**WEB çasje
2007**



**TË DREJTAT E NJERIUT
TALENTËT E RINJ
PROFESIONE TË REJA**

www.lpkosova.com

January 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

February 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

March 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

April 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

May 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

June 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

July 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

August 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

September 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

October 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

November 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

December 2007

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						